

**STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“F.&C. GRUPPO IMPRENDITORALE D’ INVESTIMENTI SRL” SHPK**

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar\*

“F.&C. GRUPPO IMPRENDITORALE D’ INVESTIMENTI SRL” SHPK eshte themeluar nga ortaku i vetem ,FRANCESCO ROCCETTI, atesia Paolo, amesia Laurenzii Agnese, i datelindjes 25.06.1978, lindur ne Giulianova(TE) dhe banues ne Toronto(TE) 64108-Via Enzo Ferrari 33. Itali, titullar i pasaportes me Nr YB7238426 ,leshuar nga autoritetet italiane ne daten 09.02.2021 ,me vullnet te lire themelon Shoqerine me pergjegjesi te Kufizuar” “F.&C. GRUPPO IMPRENDITORALE D’ INVESTIMENTI SRL” SHPK

Themeluesi, i cili eshte madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar ne perputhje me ligjin, hartoje edhe statutin e Shoqerise si me poshte:

**EMERTIMI I SHOQERISE**

Emertimi i shoqerise eshte

**“F.&C. GRUPPO IMPRENDITORALE D’ INVESTIMENTI SRL ” sh.p.k**

Shoqeria ushtron aktivitetin ne baze te legjislacionit ne fuqi te Republikes se Shqiperise duke u mbeshtetur ne Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare” i ndryshuar dhe si person juridik e zhvillon aktivitetin ne perputhje me kete legjislacion dhe me normat e ketij statuti. Ky statut hyn ne fuqi pas regjistrimit ne QKB.

- “Statuti” është Statuti i shoqërisë;

**Kreu I**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

**Neni 1:**

**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

(1) Sot, më 23.Mars.2021, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin  
“**F.&C. GRUPPO IMPRENDITORALE D’ INVESTIMENTI SRL** “ SH.P.K.

(2) Themeluesi e shoqërisë Z. FRANCESCO ROCCETTI; banues ne Toronto(TE) 64108-Via Enzo Ferrari 33. ITALI.

**Neni 2:**

**Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Konsulencë ekonomike, financiare, menaxheriale, shitjeje, konsulencë per kredimarrje ne sistemin bankar shqiptar, hartim plan biznesi, studim tregu, konsulencë marketingu dhe promovimi aktiviteti te subjekteve, konsulencë ne burimet njerezore, sherbime perfaqesimi ndaj subjekteve edhe individeve, vendas apo te huaj, ndermjetesim financiar edhe trajnime etj, per bizneset edhe individet, si dhe cdo



sherbim tjeter financiar dhe kontabel te lejuar nga legjislacioni shqiptar per kete lloj shoqerie qe ka lidhje me kete objekt veprimtarie.

Import eksport tregeti me shumice e pakice, tregetim te mallrave industriale, ushqimore, fruta perime, pije te ndryshme alkoolike e freskuese, veshmbathje, materiale ndertimi, pjese kembimi automjete, makinerive, pajisjeve hidrosanitare, mobiljeve, artikujve kozmetik te perpunuara dhe te papaerpunuara bime medicinale, lende drusore, plastike dhe durealumini dhe cdo lloj malli te lejuar nga legjislacioni shqiptar per kete lloj shoqerie.

Aktivitet ne fushen e agjensise imobilare, shitje-blerje pasurish te luajteshme dhe te paluajtshme dhe cdo veprimtari e lidhur me te.

Aktivitetet ne fushen e ndertimeve civile dhe industriale te te gjitha llojeve.

Per kryerjen e aktivitetit te shoqerise se mesiperme, per te cilen do te nevojitet leje perkatese, shoqeria eshte e detyruar te pajiset me kete leje nga organet kopetente.

#### Neni 3:

##### Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë:

Per nje afat te papercaktuar.

#### Neni 4:

##### Selia

Selia e shoqërisë do te jete ne Tirane, Rruga "Thanas Ziko" pall 65/I

#### Kapitali

##### Neni 5

##### Kapitali themeltar

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 Lekë. Kapitali i shoqerise ndahet ne 1(nje) kuote, numri i pjeseve 1(nje), pjesmarrja ne perqindje 100%.

Kontributi i ortakut mund të jetë në para te cilat jane paguar plotesisht dhe menjehere.

#### Neni 6:

##### Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogelimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

## Neni 7

### Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## KREU III

### ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

#### Neni 8

#### Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton edo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çeshtjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çeshtje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjeter apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakeve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

## Neni 9

### Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpresa datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

## Neni 10

### Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## Neni 11

### Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vodos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vodos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

## Neni 12

### Përjashtimi nga e drejta e votes

I.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votes nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimin e ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesit, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### Neni 13

#### Administrimi

- (1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizik si administrator të shoqërisë. Afati i emërimit eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi I administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- (2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administrator të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërimi bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

### Neni 14

#### Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë dhe detyre të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen përmbytjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet përmbytjen e fitimeve, I paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme përmiratim;
- d) krijojnë një system paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtar edhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë përmbytjen e veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët janë te detyruar te therrasin Asamblene e Pergjitheshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk I mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## Neni 15

### Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojet e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojet përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispózitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesid;  
b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;  
c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;  
ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;  
d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosvëprimi është kryer në mirëbesim.
3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:  
a) u kthen ortakëve kontributet;  
b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;  
c) u shpérndan aktivet shoqërisë;  
ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikojë që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;  
d) jep kredi.

-1,278,484.05-

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkësë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

**Kreu IV**  
**Viti finansiar-ekspertet**

**Neni 16**

**Viti Financiar**

Viti finansiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finansiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

**Neni 17**

**Ekspertet**

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithesvetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar percatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit finansiar yjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtës vendimore qe ka.

**Kreu V**  
**Prishja –riorganizimi i shoqërisë**

**Neni 18**

**Prishja dhe likuidimi**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne edo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne edo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper ”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

## Neni 19

### Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sjpas Vendimit të Mbledhjes së Asamblese se Përgjithshme të Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

## Neni 20

### Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

## Neni 21


### Mosmarrëveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.

**ORTAKU I VETEM  
E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"F.&C. GRUPPO IMPRENDITORALE D' INVESTIMENTI SRL" SHPK**

FRANCESCO ROCCETTI

Francisco  
Roccati



I PRANISHEM NE NENSHKRIMIN E AKTIT TE THEMELIMIT PERKTHYESI

Klodian Kovaci, atesia Petrit, amesia Franceskina, shtetas Shqiptar, lindur ne Shkoder dhe banues ne TIRANE, me adrese E Dibres; Nd.398; H. 1; Njesia Administrative Nr.4; Njesia Bashkiake Nr.4; 1005; Tirane, lindur me 10/09/1980, gjendja civile "I martuar", madhor, me zotesi te plete juridike per te vepruar, me Leternjoftim ID nr.035688090 dhe nr.personal I00910100W

  
KLODIAN KOVACI  
PERKTHYES I BETUAR  
TRADUTTORE GIURATO  
0698193399

**AKT THEMELIMI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR:  
“F.&C. GRUPPO IMPRENDITORALE D’ INVESTIMENTI SRL” SHPK**

Sot, me date 29.03.2021, personi I meposhtem:

FRANCESCO ROCCETTI, atesia Paolo, amesia Laurenzii Agnese, i datelindjes 25.06.1978, lindur ne Giulianova(TE) dhe banues ne Toronto(TE) 64108-Via Enzo Ferrari 33. Itali, titullar i pasaportes me Nr YB7238426 ,leshuar nga autoritetet italiane ne daten 09.02.2021 ,me vullnet te lire themelon Shoqerine me pergjegjesi te Kufizuar

**“F.&C. GRUPPO IMPRENDITORALE D’ INVESTIMENTI SRL”SHPK**, dhe harton per kete qellim Aktin e Themelimit te shoqerise me permbajtje si vijon:

**Neni 1**

Krijohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emertimin

**“F.&C. GRUPPO IMPRENDITORALE D’ INVESTIMENTI SRL” shpk.**

**Neni2**

Shoqeria deklarohet e krijuar nen ruajtjen e pote te normave qe permban ky akt.

**Neni 3**

Veprimtaria e shoqerise, marrdheniet e saj me personat e trete juridike e fizike, vendas e te huaj, shteterore e private, irregullohen ne baze te Ligjit nr.9901 date 14.04.2008 si dhe te akteve te tjera ligjore e nenligjore te dala ne zbatim te ketij ligji. Shoqeria pergjigjet vetem per pasurine e saj.

**Neni 4**

Selia e shoqërisë do te jete ne Tirane, Rruga” Thanas Ziko” pall 65/1

**Neni 5**

Veprimtaria e shoqerise, emertimi dhe selia e saj te percaktuara ne kete Akt-Themelimi nuk mund te ndryshoje pa pelqimin e themeluesit te saj.

**Neni 6**

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:

Konsulence ekonomike, financiare, menazheriale, shitjeje, konsulence per kredimarrje ne sistemin bankar shqiptar, hartim plan biznesi, studim tregu, konsulence marketingu dhe promovimi aktiviteti te subjekteve, konsulence ne burimet njerezore, sherbime perfaqesimi ndaj subjekteve edhe individive, vendas apo te huaj, ndermjetesim financier edhe trajnime etj, per bizneset edhe individet, si dhe edo sherbim tjeter financier dhe kontabel te lejuar nga legjislationi shqiptar per kete lloj shoqerie qe ka lidhje me kete objekt veprimtarie.

Import, eksport, tregti me shumice e pakice, tregetim te mallrave industriale, ushqimore, fruta perime, pije te ndryshme alkoolike e freskuese, veshmbathje, materiale ndertimi, pjese kembimi te automjeteve, makinerive, pajisjeve hidrosanitare, mobilje, artikuj kozmetik te perpunuara dhe te papaerpunuara bime

medicinale, lende drusore, plastike dhe duralumini dhe cdo lloj malli te lejuar nga legjislacioni shqiptar per kete lloj shoqerie.

Aktivitete ne fushen e agjensise imobilare, shitje-blerje pasurish te luajteshme dhe te paluajtshme dhe cdo veprimtari e lidhur me te.

Aktivitetet ne fushen e ndertimeve civile dhe industriale te te gjitha llojeve.

Per kryerjen e aktivitetit te shoqerise se mesiperme, per te cilen do te nevojitet leje perkatese, shoqeria eshte e detyruar te pajiset me kete leje nga organet kopetente.

#### **Neni 7**

Kapitali themeltar fillesttar i shoqërisë është 100.000 Lekë . Zoterohet nga Ortaku i vetem themelues Z.Francesco Rocetti.

#### **Neni 8**

Per nevoja te pune dhe te ushtrimit te aktivitetit te tyre, shoqeria mund te cel llogari ne cdo banke te njohur me ligj, qofte kjo private apo shteterore.

#### **Neni 9**

Kohezgjatja e aktivitetit te shoqerise do te jete per nje kohe mbi 10 vjet dhe do filloje nga momenti i regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit, me perjashtim te rasteve kur mbaron sipas parashikimeve ne ligj ose me vendim te asamblese se ortakeve.

Gjithashtu, shoqeria mund te shperndahet ne cdo kohe per rastet e parashikuara ne ligj.

#### **Neni 10**

Shoqeria perbehet nga nje ortake; Francesco ROCCETTI.

Administrator I shoqerise eshte ortaku I vetem, Francesco ROCCETTI,i cili zgjidhet per nje afat 5 vjear, me te drejte rizgjedhjeje.

#### **Neni 11**

Ortaku mban perjegjesi vete per ruajtjen e karakterit te fshehtesise se aktivitetit dhe te dokumentacionit te shoqerise.

#### **Neni 12**

Organet e shoqerise jane:

- 1- Vendimi i Asamblese se Ortakeve.
- 2- Administrator i shoqerise, Francesco ROCCETTI
- 3- Komisioni i Eksperteve Kontabel

Modalitetet e formimit dhe funksionimit te tyre percaktohen ne statutin bashkengjitur.

#### **Neni 13**



Per nevoja te punes, kjo shoqeri, mundt te punesoje edhe punonjes specialist te ndryshem, me kontrata te rregullta pune, sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

**Neni 14**

Dispozita me te hollesishme per shoqerine percaktohen ne statutin bashkengjitur.

**Neni 15**

Ky Akt-Themelimi u redaktua ne 4 kbpje.

Administratori Francesco ROCCETTI do te veproje ne emer te shoqerise ne formim e siper deri ne regjistrimin e saj prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

ORTAKET  
FRANCESCO ROCCETTI  
*Francesco Rocca*

**I PRANISHEM NE NENSHKRIMIN E AKTIT TE THEMELIMIT PERKTHYESI**

Klodian Kovaci, atesia Petrit, amnesia Franceskina, shtetas Shqiptar, lindur ne Shkoder dhe banues ne TIRANE, me adresë E Dibres; Nd.398; H.1; Njesia Administrative Nr.4; Njesia Bashkiake Nr.4; 1005; Tirane, lindur me 10/09/1980, gjendja civile "I martuar", madhor, me zotesi te plete juridike per te vepruar, me Leternjostim ID nr.035688090 dhe nr.personal I00910100W

*Klodian Kovaci*

*Kovaci*

KLODIAN KOVACI  
PERKTHYES I BETUAR  
TRADUTTORE GIURATO  
0698193399